

## GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË

P. nr. 34/10

28 janar 2011

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË**, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it, Christine Lindemann-Proetel si kryetare e trupit gjykues dhe Klaus Jung dhe Hajnalka Karpati si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it, Noora Aarnio si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër;

**Visar Tahirit**, të akuzuar për

**Vrasje të rëndë**, sipas nenit 147 pikës 7 të Kodit Penal të Kosovës (KPK),

Pas mbajtjes së seancave publike të shqyrtimit gjyqësor me datën 18, 19, 25, 26 dhe 28 janar 2011, në prani të të akuzuarit Visar Tahirit, avokatit të tij mbrojtës Agim Lushtës, palës së dëmtuar Gynej Rexhepi dhe përfaqësuesit të tij ligjor Avni Gjakovës, si dhe prokurorit publik të EULEX-it, Antonio Pastore, pas shqyrtimit dhe votimit të mbajtur me 28 janar 2011, shpalli – të njëjtën ditë – në prani të të akuzuarit Visar Tahirit, avokatit të tij mbrojtës Agim Lushtës, palës së dëmtuar Gynej Rexhepi dhe përfaqësuesit të tij ligjor Avni Gjakovës, si dhe të prokurorit publik të EULEX-it, këtë

### AKTGJYKIM

I. I akuzuari **Visar Tahiri**, pa nofkë, i biri i Ali Tahirit dhe Luljeta Havollit, i lindur me 7.11.1979 në Mitrovicë, Kosovë, shqiptar me përkatësi etnike, banor i \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, punëtor ndërtimtarie, \_\_\_\_\_, i padënuar më parë, në paraburgim nga 15.5.2010 deri me 21.12.2010,

**NUK ËSHTË FAJTOR**

**sepse** nuk është dëshmuar se me datën 2.10.2001 në Rrugën e hekurudhës në Mitrovicë, në veturën e Arif Rexhepit (Zastava 128-Skala 55" me targa 289-KS-009) rreth orës 23.00, ka privuar nga jeta me qëllim Arif Rexhepin pasi që kishte kuptuar se Rexhepi kishte 3.500 – 4.000 DM, me qëllim të përfitimit të dobisë materiale, duke shkrepur dy plumba nga një distancë e shkurtër nga një armë zjarri e kalibrit 7.65 mm e prodhimit të paidentifikuar në anën e djathtë të kokës së Rexhepit, ku njëri e ka qëlluar Arif Rexhepin në qafë ndërsa tjetri në afërsi të veshit.

Prandaj, sipas nenit 390 pikës 3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), i akuzuari Visar Tahiri **llohet** nga akuza **Vrasje e rëndë** sipas nenit 147 pikës 7 të Kodit Penal të Kosovës (KPK),

II. Sipas nenit 103 paragrafit (1) të KPPK-së, shpenzimet e procedurës penal nga neni 99 paragrafi (2) nënparagrafët 1 deri në 5 të KPPK-së, shpenzimet e nevojshme si dhe kompensimi dhe shpenzimet e nevojshme të avokatit të tij, si dhe shpenzimet e përkthimit do të paguhen nga burimet buxhetore.

## **Arsyetimi**

### **A.**

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë është kompetente për gjykimin e kësaj lëndë sipas nenit 23 pikës 1) i) dhe nenit 27 paragrafit (1) të KPPK-së.

Gjyqtarët e EULEX-it janë caktuar në këtë lëndë sipas vendimit të Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it të datës 2 dhjetor 2010, në bazë të neneve 3.3 dhe 3.5 të Ligjit për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it.

### **B.**

Gjykata liron të akuzuarin sepse nuk është vërtetuar se ai kishte kryer veprën me të cilën ngarkohej, neni 390 pika 3 e KPPK-së.

## I.

Me aktakuzën PP Nr 174/01, të datës 21 qershor 2010, i akuzuari ishte akuzuar për Vrasje të rëndë në kundërshtim me nenin 147 pikën 7 të KPK-së për privim të qëllimshëm nga jeta të Arif Rexhepit me qëllim të përfitimit të dobisë materiale me datën 2 tetor 2001.

Gjatë procedurës, gjykata – dhe mbase edhe palët – kanë vënë re se ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPK 1977)<sup>1</sup>. Arjedhimisht, i akuzuari është dashur të akuzohej për Vrasje nga neni 30 paragrafi 1 në lidhje me paragrafin 2 pikën 3 të LPK-së<sup>2</sup>, ndërsa gjykata është dashur të përcaktojë nëse ligji i ri do të ishte më i favorshëm për të akuzuarin dhe nëse po, ajo do të duhej ta zbatojë atë sipas nenit 2 paragrafit 2 të KPK-së. Megjithatë, elementet që përbëjnë veprën penale të Vrasjes së rëndë nga neni 147 pika 7 e KPK-së, respektivisht Vrasjes nga neni 30 paragrafi 1 në lidhje me paragrafin 2 pikën 3 të LPK-së si alternativë të parë, janë krejtësisht të njëjta dhe i akuzuari nuk është gjetur fajtor. Në këtë mënyrë, ky vështrim nuk ka pasur ndonjë ndikim në aktgjykim.

## II.

Gjykata ka vërtetuar faktet në vijim:

Me 2 tetor 2001, ndërmjet orës 21.00 dhe 22.00, i akuzuari dhe i ndjeri Arif Rexhepi kanë hyrë së bashku në kafeterinë në pronësi të Enver Osmanit në qendër të qytetit të Mitrovicës, ku janë ulur në një tavolinë të ndarë, kanë porositur disa birra dhe kanë biseduar me njëri tjetrin. Arif Rexhepi pastaj ka vozitur veturën e tij "Zastava 128-Skala 55" me targa 289-KS-009, ashtu siç ka bërë zakonisht, në drejtim të shtëpisë së tij në "Lagjën e Boshnjakeve" (në pjesën veriore të Mitrovicës). Kur po kalonte afër dyqanit të vëllait të tij Fadil Rexhepit afër Muzeut të Qytetit, ai i ka rënë borisë për ta përshëndetur. Në atë kohë ai kishte një pasagjer të ulur në ulësen e përparme të pasagjerit dhe një tjetër në ulësen e pasme prapa shoferit.

<sup>1</sup> Të lexohet me Ligjin Penal të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LP-RSFJ 1976)

<sup>2</sup> Neni 30 LPK:

(1) Kushdo që ia merr jetën një personi tjetër dënohet më së paku pesë vite burgim.  
(2) Me dënim me burgim prej së paku dhjetë viteve apo me dënim më vdekje dënohet:  
... [3] personi që ia merr jetën një personi tjetër për përfitim personal, ...

Në Rrugën e hekurudhës ndërmjet pak pas orës 22.30 dhe pak para orës 22.45, derisa ishte ulur në ulësen e shoferit të veturës së tij, Arif Rexhepi është qëlluar me dy plumba me armë zjarri të kalibrit 7.65 mm e prodhimit të paidentifikuar në anën e djathtë të kokës së tij. Një plumb e ka goditur në qafë, ndërsa tjetri në afërsi të veshit të djathtë. Plumbat kanë shkaktuar plagë fatale që kanë rezultuar në vdekje të menjëhershme. Pas incidentit, organet hetuese nuk kanë mundur ta gjejnë vendndodhjen e të akuzuarit.

Megjithatë, gjykata nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:

- i akuzuari kishte qenë ai që ishte ulur në ulësen e përparme të pasagjerit, kur Arif Rexhepi kaloi afër dyqanit të vëllait të tij me veturën e tij dhe se
- ishte i akuzuari ai që e qëlloi për vdekje Arif Rexhepin.

### III.

Gjatë procedurës së provave, është bërë administrimi i provave si në vijim:

Gjykata ka dëgjuar

- (1) Dëshmitarin dhe (palën e dëmtuar) Gynej Rexhepin
- (2) Dëshmitarin dhe (palën e dëmtuar) Fadil Rexhepin
- (3) Dëshmitaren Myzejene Rexhepi
- (4) Dëshmitarin Adnan Rudniku
- (5) Dëshmitarin Fatmir Deda
- (6) Dëshmitarin ekspert Dr. Tefik Gashi

Dokumentet e mëposhtme janë lexuar dhe janë futur në prova:

- (7) Deklarata e Enver Osmanit e dhënë në NjRRH në Mitrovicë me 04.10.2001
- (8) Deklarata e Enver Osmanit e dhënë para gjyqtarit hetues me 15.04.2003
- (9) Urdhëresa për bastisjen e shtëpisë së të dyshuarit, e lëshuar nga gjyqtari hetues me 07.11.2001
- (10) Urdhri për arrestimin e të dyshuarit e lëshuar nga gjyqtari hetues me 26.12.2001
- (11) Raporti mjekoligjor, i datës 20.12.2010, lidhur me krahasimin e gjurmëve të gishtërinjve,
- (12) Raporti fillestar i incidentit i datës 03.10.2001
- (13) Raporti i policit i nënshkruar nga polici i UNMIK-ut Ungureanu Florin, pa datë

- (14) Raporti i karabinierit italian Guisepppe de Natale dhe karabinierit Sebastian Vincenzo të dhënë në NjRH në Mitrovicë me 03.10.2001
- (15) Deklarata e pjesëtarit francez të KFOR-it Julien Pruner e dhënë në NjRH në Mitrovicë me 16.10.2001
- (16) Deklarata e pjesëtarit francez të KFOR-it Tafilagi Vakuliafa e dhënë në NjRH në Mitrovicë me 16.10.2001
- (17) Raporti i identifikimit mjekoligjor i datës 03.10.2001
- (18) Raporti i obduksionit dhe fotografitë e bashkangjitura
- (19) Raporti balistik
- I akuzuari ka ushtruar të drejtën e tij për të heshtur.

#### IV.

Gjykata ka vlerësuar provat si në vijim:

1.

*Me 2 tetor 2001, ndërmjet orës 21.00 dhe 22.00, i akuzuari dhe i ndjeri Arif Rexhepi kanë hyrë së bashku në kafeterinë në pronësi të Enver Osmanit në qendër të qytetit të Mitrovicës, ku janë ulur në një tavolinë të veçantë, kanë porositur disa birra dhe kanë biseduar me njëri tjetrin. Në orën 22.30 apo pak pas kësaj kohe ata janë larguar nga kafeteria së bashku.*

Kjo kryesisht është vërtetuar nga dëshmia e tani të ndjerit Enver Osmanit, i cili ka dhënë deklaratë në polici me 4 tetor 2001 [7] dhe para gjyqtarit hetues me 15 prill 2003 [8]. Në të dy deklaratat ai përputhshmërisht ka thënë se i njihte të akuzuarin dhe Arif Rexhepin mirë, ata asnjëherë më parë nuk kishin qenë së bashku në kateterin e tij, por me 2 tetor 2001, ata kishin hyrë aty së bashku, ishin ulur në një tavolinë të veçantë duke biseduar me njëri tjetrin, kishin porositur birra dhe ishin larguar së bashku. Në deklaratën e dhënë në polici ai kishte thënë se ata kishin qëndruar aty nga ora 22.00 deri në orën 22.30. Në deklaratën e dhënë para gjyqtarit hetuese, ai kishte thënë se ata kishin arritur rreth orës 21.00 - 21.30 dhe ishin larguar rreth orës 22.30 – 22.40.

Dëshmitari Gynej Rexhepi [1], i biri i Arif Rexhepit, ka konfirmuar se kishte dëgjuar nga Enver Osmani se babai i tij dhe i akuzuari kishin qenë në kateterin e tij dhe ndoshta edhe për kohën se kur ishin larguar. Gynej Rexhepi ishte i sigurt se atij i kishte thënë

Adnan Rudniku, i cili ishte i pranishëm në kafeteri atë mbrëmje, se Arif Rexhepi dhe i akuzuari ishin larguar në orën 22.30.

Dëshmitari Fadil Rexhepi [2], vëllai i Arif Rexhepit, ka thënë se ata kishin kuptuar nga Enver Osmani se vëllai i tij dhe i akuzuari kishin qenë në kafeterinë e tij dhe se ishin larguar në orën 22.40; në deklaratën e tij dhënë policisë me 04 tetor 2001 ai kishte thënë se Enver Osmani i kishte treguar se ata ishin larguar ndërmjet orës 22.30 dhe 22.45.

Dëshmitari Adnan Rudniku [4] ka konfirmuar praninë e Arif Rexhepit, të cilin ai e njohte, në kafeteri atë mbrëmje dhe se ai ishte i shoqëruar nga një i ri në të njëzetat e hershme, të cilin dëshmitari nuk i njohte. Ai ka thënë se ata kishin arritur rreth orës 21.30 dhe ende gjendeshin aty, kur ai u larguar para orës 22.00.

Dëshmitari Fatmir Deda [5], i cili punonte si kamerier në kafeteri, ka dëshmuar se Arif Rexhepi dhe një i ri kishin qëndruar së bashku në kafeteri për rreth gjysme ore në ditën e incidentit, pasdite rreth orës 17.00. Ai a njohte të riun si figurë, sepse ai kishte ardhur në kafeteri disa herë me parë me të birin e Enver Osmanit. Kur është pyetur nëse mund ta identifikonte këtë person në sallën e gjyqimit, ai ka treguar me gisht kah i akuzuari<sup>3</sup> ndonëse duke shtuar se nuk mund të ishte mjaft i sigurt.

Diferencat e vogla në dhe ndërmjet të dëshmitarëve Enver Osmani, Gynej Rexhepi, Fadil Rexhepi dhe Adnan Rudniku për sa i përket kohës së saktë kur Arif Rexhepi së bashku me të akuzuarin kishin hyrë dhe ishin larguar nga kafeteria nuk e vënë në dyshim besueshmërinë e cilitdo nga këta dëshmitarë. Enver Osmani dhe Adnan Rudniku nuk kanë pasur arsye që t'i kushtojnë vëmendje kohës së saktë kur Arif Rexhepi së bashku me të akuzuarin ishin larguar nga kafeteria. Vetëm pasi kishin kuptuar për vrasjen, kjo u bë një çështje e rëndësishme dhe atyre u është dashur ta përcaktojnë kohën në bazë të kujtesës së tyre. Gynej Rexhepi dhe Fadil Rexhepi kanë mundur të mbështeten vetëm në atë që kishin dëgjuar dhe ajo po ashtu mund të ketë ndryshuar në një masë të caktuar.

Vetëm deklarata e Fatmir Dedës ndryshon rrënjësisht nga të tjerat për sa i përket kohës së ditës, kur i akuzuari Arif Rexhepi kishin qenë në kafeteri. Ndonëse ky dëshmitar kishte shfaqur një kujtesë çuditërisht të detajuar madje edhe sa i përket llojit të birrës të cilën ata e kishin porositur, gjykata është e bindur se dëshmitari ishte gabuar sa i përket kohës. Pothuajse dhjetë vite kanë kaluar nga incidenti; kjo ishte hera e parë që ai ishte kërkuar të dëshmonte lidhur me këtë dhe për shkak të vështirësive në dorëzimin ftesave

---

<sup>3</sup> I akuzuari në atë kohë ishte ulur në mesin e publikut ndërsa më parë ai ishte ulur prapa dëshmitarit.

ai nuk ka pasur kohë që të përgatitet për deklaratën e tij. Në këtë mënyrë, është e kuptueshme se ai mund të ketë ngatërruar diçka lidhur me kohën e ngjarjes që kishte përshkruar.

Prandaj, për sa i përket kohës kur i akuzuari dhe Arif Rexhepi kishin qenë në kafeteri, gjykata mbështetet në deklaratat e njëjta të katër dëshmitarëve tjerë.

Sa i përket raporteve ndërmjet të akuzuarit dhe Arif Rexhepit, nuk është vërtetuar asgjë relevante. Dëshmitari Enver Osmani në deklaratën e tij të datës 4 tetor 2001, ka thënë "Arifi po fliste sikur po e arsyetonte vetën", por në deklaratën e tij të datës 15 prill 2003, ai kishte thënë "ata hynë duke qeshur" dhe "Unë nuk kam mundur të vërej ndonjë ndryshim apo shqetësim as tek Arifi e as tek Visari". Në mënyrës të ngjashme, dëshmitari Adnan Rudniku në deklaratën e tij të datës 10 nëntor 2001, ka thënë "Arifi po përpiquej ta arsyetonte vetën" dhe e ka përshkruar të riun i cili ishte me Arif Rexhepin në kafeteri si "sikurse ai nuk donte që të vërehej", dhe "përpiquej ta fshihte fytyrën e tij". Megjithatë, gjatë marrjes në pyetje nga gjykata, ai ka thënë se nga pozita e tij vështirë se mund ta shihte fytyrën e atij personi, ata po bisedonin normalisht dhe ai nuk kishte parë ndonjë kërcenim. Dëshmitari Fatmir Deda ka dëshmuar "ata nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje me njëri tjetrin, ata po bisedonin normalisht." Duke marrë parasysh këto deklarata kontradiktore, gjykata nuk mund të mbështetet në asnjërin version.

Të gjithë këta dëshmitarë kanë pohuar se asnjëherë me parë nuk i kishin parë së bashku të akuzuarin dhe Arif Rexhepin. Kështu që, gjykata pranon se qëndrimi i tyre së bashku në kafeteri ishte diçka e pazakonshme.

Dëshmitari Gynej Rexhepi më tej ka deklaruar se në ditën e incidentit Arif Rexhepi kishte me veti një sasi prej rreth 3.500 to DM për të paguar qiranë për dy dyqanet për një kohë në avancë. Mirëpo, nuk ekzistojnë prova që tregojë se i akuzuari e ka ditur për paratë e po ashtu nuk ka prova se Arif Rexhepi i kishte ende paratë me vete, kur është vrarë.

## 2.

*Arif Rexhepi pastaj ka vozitur veturën e tij "Zastava 128-Skala 55" me targa 289-KS-009, ashtu siç ka bërë zakonisht, në drejtim të shtëpisë së tij në "Lagjën e Boshnjakeve" (në pjesën veriore të Mitrovicës). Kur po kalonte afër dyqanit të vëllait të tij Fadil Rexhepit afër Muzeut të Qytetit, ai i ka rënë borisë për ta përshëndetur. Në atë kohë ai kishte një pasagjer të ulur në ulësen e përparme të pasagjerit dhe një tjetër në ulësen e pasme prapa shoferit.*

Këto fakte janë vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve Gynej Rexhepi, Fadil Rexhepi dhe Myzejene Rexhepi, për aq sa janë të njëjta.

Dëshmitari Fadil Rexhepi ka thënë se natën që ishte vrarë vëllai i tij, vëllai i tij kishte kaluar afër dyqanit të tij me veturë ndërmjet orës 22.40 dhe 22.50 dhe i kishte ra burisë për ta përshëndetur. I akuzuari ishte ulur në ulësen e përparme të veturës e po ashtu gjendej edhe një person tjetër mashkull ulur prapa. Vetë Fadil Rexhepi ishte brenda dyqanit, afër dritares dhe distanca nga vetura ishte rreth 15 metra. Pas rreth 10 minutave, një myshteri e kishte njoftuar atë se vëllai i tij ishte vrarë. Ai i tha nipit të tij Gynej Rexhepit të njëjtën natë se e kishte parë vëllanë e tij duke kaluar pranë me veturën e tij me të akuzuarin në ulësen e parë dhe një person tjetër prapa shoferit. Ai nuk kishte mundur ta shihte me të vërtetë vëllanë e tij dhe personin e tretë, por e kishte njohur Visar Tahirin, i cili ishte myshteri i tij. Nuk ishte e pazakonshme ta shihte vëllanë e tij të shkonte në pjesën veriore të Mitrovicës me persona tjerë në veturë, pasi që vëllai i tij shpesh i merrte me veturë të rinjtë.

Dëshmitari Gynej Rexhepi ka konfirmuar se axha i tij Fadil Rexhepi i kishte thënë se e kishte parë Arif Rexhepin duke kaluar pranë me të akuzuarin në veturën e tij dhe duke i rënë burisë në orën 22.45. Axha i tij gjithashtu i kishte treguar edhe për një person tjetër që ishte në veturë të cilin nuk kishte mundur ta shite mirë.

Myzejene Rexhepi, gruaja e Fadil Rexhepit, ka dëshmuar [3] se në ditën e incidentit në mbrëmje ajo po i ndihmonte bashkëshortit të saj në dyqan. Derisa po përgatiteshin për ta mbyllur, ajo ishte përjashta për të t'i futur disa paketa, ndërsa bashkëshorti i saj ishte tek arka afër dritares. Ajo kishte parë veturën e Arif Rexhepit duke kaluar pranë dhe kishte dëgjuar se i kishte rënë burisë, por ajo nuk e kishte parë atë. E as nuk kishte parë nëse dikush tjetër ndodhej në veturë. Pas rreth dhjetë deri në pesëmbëdhjetë minutave ata kuptuan se Arif Rexhepi ishte vrarë. Pas kësaj, bashkëshorti i saj i kishte thënë se ai ishte i bindur se dikush ndodhej në veturë me Arif Rexhepin. Ai mund të ketë pasur dyshime rreth identitetit të atij personi dhe pas pak, kur të gjithë në Mitrovicës po i referoheshin Visar Tahirin, ajo dhe bashkëshorti i saj po ashtu kishin folur për të. Ajo e kishte pyetur atë disa herë nëse ishte i sigurt se kishte parë Visar Tahirin në veturë dhe ai nuk ishte i sigurt, "por pasi që njerëzit në Mitrovicës flisnin....".

Gjykata nuk ka dyshim se Arif Rexhepi ka kaluar pranë dyqanit të vëllait të tij Fadil Rexhepit duke i rënë burisë, siç është përshkruar nga Fadil Rexhepi dhe Myzejene Rexhepi dhe konfirmuar nga deklarata e Gynej Rexhepit. Sa i përket kohës kur ka kaluar pranë, është logjike se duhet të ketë qenë pasi që Arif Rexhepi ishte larguar nga

kafeteria dhe para se të qëllohej për vdekje. Megjithatë, gjykata nuk mbështetet në kohën e cila në mënyrë precize ishte përcaktuar nga Fadil Rexhepi, pasi që ai nuk kishte arsye për të kontrolluar kohën e saktë në atë moment, as kur Arif Rexhepi kishte kaluar pranë e as kur ai ishte njoftuar për vrasjen e vëllait të tij; kjo është bërë e rëndësishme vetëm pastaj, kur është përpjekur të kuptojë se çfarë kishte ndodhur madje edhe më tepër kur ai ishte marrë në pyetje nga policia.

Gjykata është e sigurt se Fadil Rexhepi kishte parë dy persona tjerë me vëllanë e tij në veturë, sepse këtë tashmë e kishte përmendur edhe Gynej Rexhep në deklaron e tij të parë të dhënë në polici me 4 tetor 2001, se axha i tij Fadili i kishte thënë kështu, dhe se Fadil Rexhepi ka thënë të njëjtën gjë në të gjitha deklaratat e tij të mëvonshme (8 qershor 2002, 14 shkurt 2003 dhe para gjykatës). Myzejene Rexhepi ka konfirmuar se bashkëshorti i saj kishte folur më të lidhur me personat tjerë në veturë.

Sidoqoftë, gjykata nuk është e bindur se Fadil Rexhepi e ka njohur të akuzuarin si personi në ulësen e përparme të pasagjerit. Kjo nuk do të thotë se Fadil Rexhepi ka dhënë qëllimisht dëshmi të pavërtetë në gjykatë. Vetë ai mund të jetë i bindur se e ka njohur të akuzuarin në momentin kur vetura e vëllait të tij kishte kaluar pranë dyqanit të tij, por kjo bindje mund të ketë rezultuar nga konkluzioni se “duhet të ketë qenë ai”. Dëshmitarja Myzejene Rexhepi, e cila kishte dëshmuar në mënyrë shumë të qartë dhe të kujdesshme, ka thënë se bashkëshorti i saj në fillim nuk ishte i sigurt rreth identitetit të pasagjerit që ishte ulur në ulësen e përparme të pasagjerit në veturë. Pastaj ajo ka përshkruar saktësisht procesin se si kjo bindje ka lindur nga dyshimi që kanë pasur shumë njerëz tjerë (“por pasi që njerëzit në Mitrovicë flisnin...”). Gjykata nuk mund të shohë ndonjë motiv për këtë dëshmitare që të jap dëshmi të pavërtetë në interes të të akuzuarit. Më tej, Fadil Rexhepi në deklaratën e tij të dhënë në polici me 4 tetor 2001 ka thënë duke ju referuar personit me të cilin vëllai i tij kishte qenë në kafeteri: “Mendoj se z. Enver e njeh këtë person, sepse ai ma ka treguar emrin e tij, por mua nuk më kujtohet.” Po ta kishte njohur ai më të vërtetë të akuzuarin dy ditë me parë në veturën e vëllait të tij, nuk do të ishte aspak e besueshme se atij nuk do t'i kujtohej emri i të akuzuarit që ishte përmendur nga Enver Osmani. Përveç kësaj, sipas deklaratës së Fadil Rexhepit vëllai i tij Arif Rexhepi ka kaluar nëpër të njëjtën rrugë çdo mbrëmje dhe shpesh i ka marrë me veturë të rinjtë, prandaj Fadil Rexhepi nuk do t'i kushtonte ndonjë vëmendje të veçantë kalimit aty pranë me dy pasagjerë në veturë. Dhe në çdo rast, pasi që ishte errësirë, kushtet për të njohur dikë duke kaluar pranë me veturë ishin të vështira.

### 3.

*Para se të arrinte në "Lagjen e Boshnjakeve", në Rrugën e hekurudhës ndërmjet pak pas orës 22.30 dhe pak para orës 22.45, derisa ishte ulur në ulësen e shoferit të veturës së tij, Arif Rexhepi është qëlluar me dy plumba nga një armë zjarri e kalibrit 7.65 mm e prodhimit të paidentifikuar në anën e djathtë të kokës së tij. Një plumb e ka goditur në qafë, ndërsa tjetri në afërsi të veshit të djathtë. Plumbat kanë shkaktuar plagë fatale që kanë rezultuar në vdekje të menjëhershme.*

*Pas incidentit, organet hetuese nuk kanë mundur ta gjejnë vendndodhjen e të akuzuarit.*

Koha dhe vendi, kur dhe ku Arif Rexhepi është gjetur i qëlluar për vdekje në veturën e tij janë vërtetuar nga raporti i karabinierëve italian Vincenzo Sebastiani dhe Giuseppe de Natale i datës 03 tetor 2001 [14]. Ata kanë potencuar se kishte qenë ora rreth 22.45 me 2 tetor 2001, kur kishin vërejtur një veturë të parkuar me derën e majtë të hapur dhe trupin e një burri, që më vonë ishte identifikuar si Arif Rexhepi. Në mënyrë të ngjashme, edhe pjesëtarët francez të KFORIT, Julien Prunier [15] dhe Tafilagi Vakauliafa [16] e kanë konfirmuar në deklaratat e tyre të dhëna në Policinë e UNMIK-ut me 16 tetor 2001 se me 2 tetor 2001 rreth orës 22.45 ishin njoftuar për një vrasje dhe menjëherë kishin shkuar në vendngjarje për të bërë sigurimin. Pastaj ata kanë njoftuar Njësinë Rajonale e Hetuesisë rreth orës 23.00, ashtu siç ceket në raportin fillestar të incidentit të policit të SHPK-së Isak Jashari, të datës 03 tetor 2010 [12], dhe në raportin e policit të UNMIK-ut Florin Ungureanu, pa datë [13].

Raporti i identifikimit mjekoligjor [17] përshkruan saktësisht pozitën e trupit, domethënë pjesa e sipërme me kokë në tokë ishte përjashta, ndërsa pjesa e poshtme (këmbët) ishin brenda veturës në ulësen e shoferit. Janë vërejtur dy plagë plumbash në anën e djathtë të kokës. Janë gjetur dy gëzhoja fishekësh (njëra më shenjën PPU –shkronja cirilike – 32 AUTO në ulësen e shoferit dhe tjetra e kalibrit 7.65 mm SBP prapa ulëses së shoferit në dysheme). Dera e djathtë e veturës ishte e mbyllur. Këto të gjetura mbështeten nga fotografitë e bërë në vendin e krimit të cilat i janë bashkangjitur këtij raporti.

Raporti balistik [19] vërteton se të dy gëzhojat e plumbave janë shkrepur nga një armë e të njëjtin kalibër 7,65x17 mm.

Raporti i obduksionit i përgatitur nga dëshmitari ekspert - patologu Dr. Tefik Gashi [18] dhe sqarimi plotësues verbal i dhënë nga ai para gjykatës, vërteton se të dy plagët (në qafë, respektivisht në afërsi të veshit të djathtë) janë shkaktuar nga dy të shtëna me

armë zjarri dhe kanë shkaktuar vdekje të menjëhershme, pasi që ishin dëmtuar pjesët vitale të trurit. Ai me tej ka sqaruar se karakteristikat e plagëve tregojnë se të shtënat nuk janë shkrepur nga një distancë shumë e afërt, por mbase nga një distancë prej rreth një metri (nëse janë shkrepur nga revolja) deri në 1,5 metra (nëse janë shkrepur nga pushka). Sqarimet nëse distanca ka mundur të jetë vetëm 70-80 cm dhe nëse të shtënat janë shkrepur nga dikush që ishte ulur brenda në veturë, kërkojnë ekspertizë të mëtutjeshme balistike dhe rekonstruktiv të vendit të krimit.

Pasi që raporti i identifikimit mjekoligjor nuk përmend ndonjë dëmtim të dritareve në anën e djathtë, duhet të konkludohet se ose një person që po qëndronte jashtë e ka hapur derën e djathtë të përparme dhe pastaj e ka qëlluar Arif Rexhepin dhe e ka mbyllur derën, ose një person që po qëndronte brenda në veturë e ka qëlluar Arif Rexhepin dhe pastaj është larguar nga vetura.

Fakti se pas incidentit organet hetuese nuk kanë mundur ta gjejnë vendndodhjen e të akuzuarit, siç vërtetohet nga urdhëresa e gjyqtarit hetues e lëshuar me 7 nëntor 2001 [9] për bastisjen e shtëpisë së të akuzuarit dhe për ta detyruar të paraqitet para drejtësisë, si dhe nga urdhër arresti i datës 26 dhjetor 2001 [10]. Megjithatë, vendndodhja e të akuzuarit në atë kohë mbetet e panjohur.

#### 4.

*Gjykata nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ka qenë i akuzuari ai që e ka qëlluar për vdekje Arif Rexhepin.*

Nuk ekzistojnë prova të cilat do ta ndërlidhnin drejtpërsëdrejti vrasjen e Arif Rexhepit me të akuzuarin.

Askush nuk e ka parë të akuzuarin në vendin e krimit apo duke u larguar nga aty. Arma, më të cilën Arif Rexhepi është qëlluar për vdekje, nuk është gjetur kurrë. Në trupin e Arif Rexhepit nuk janë gjetur gjurmë rreth përleshjes së mundshme me të akuzuarin e as gjurmë tjera (mbetje nga baruti, gjaku apo ADN-ja e Arif Rexhepit, lëndime nga përleshja e fundit) nuk janë gjetur tek i akuzuari apo në gjërat në posedim të tij.

Një gjurmë e fshehur e gishtërinjve është marrë nga pasqyra e brendshme (E 12) dhe një gjurmë e fshehtë e shuplakës së dorës është marrë nga pjesa e jashtme e derës së djathtë të (E 11) të automjetit në vendin e krimit, siç dokumentohet nga raporti i identifikimit mjekoligjor [17]. Megjithatë, raporti mjekoligjor i datës 20.12.2010 [11] vërteton se këto gjurmë nuk përputhen me ato të të akuzuarit.

Provat e rastësore ashtu siç janë vlerësuar më lartë nuk janë të mjaftueshme për ta gjetur të akuzuarin fajtor për vrasjen e Arif Rexhepit, sepse gjykata nuk është e bindur përtej dyshimit të arsyeshëm për fajësinë e tij.

Sigurisht, faktet e vërtetuara se me 2 tetor 2001 i akuzuari kishte qenë së bashku me Arif Rexhepin së paku deri në orën 22.30 dhe më vonë është gjetur i vdekur në orën 22.45 mbështesin dyshimin e bazuar kundër të akuzuarit, sidomos pasi që qëndrimi i tyre së bashku ishte diçka e pazakonshme dhe se vendndodhja e të akuzuarin nuk mund të gjendej nga autoritetet hetuese pasi incidentit.

Megjithatë, këto mbështesin dyshime të arsyeshme. Ndonëse intervali kohor nga momenti kur i akuzuari dhe Arif Rexhepi janë larguar nga kafeteria deri në momentin kur Arif Rexhepi u gjet i vdekur nuk është më shumë se 15 minuta, ekzistojnë mundësi të ndryshme reale se çfarë kishte ndodhur ndërmjet kësaj kohe.

Është e mundshme që i akuzuari dhe Arif Rexhepi të jenë ndarë menjëherë pasi që janë larguar nga kafeteria apo që i akuzuarin të ketë qenë në ulësen e pasagjerit kur vetura kaloi pranë dyqanit të Fadil Rexhepit, por ka dalë nga vetura para se të arrinte te Rruga e hekurudhës. Edhe persona tjerë kanë mundur të hynë në veturë para apo pasi kishte kaluar pranë dyqanit të Fadil Rexhepit dhe pastaj mund ta kenë vrarë Arif Rexhepin. Gjithashtu është e mundshme që dikush ta ketë ndaluar veturën në Rrugën e hekurudhës dhe duke qëndruar jashtë ta ketë qëlluar për vdekje Arif Rexhepin.

## 5.


Nuk ka më prova tjera për tu mbledhur për një vërtetim të drejtë dhe komplet të rastit. Gjykata hodhi poshtë propozimin prokurorit publik për ta dëgjuar Ferit Sahitin në cilësinë e dëshmitarit, sepse fakti për të cilin ai do të dëshmonte, nuk është relevant për rastin. Ferit Sahiti ka dhënë deklaratë në polici me 10 qershor 2002, në të cilën ka raportuar të ketë dëgjuar një të ri në pompën e benzinës Universal duke thënë në telefon "Nuk mund të vijë në shtëpi, po shkoj në Prishtinë sepse është vrarë Arifi." Kjo do të kishte ndodhur natën kur Arif Rexhepi është vrarë (e cituar gabimisht nga polici si 24 tetor 2001). Nga një dëshmi e tillë nuk mund të nxirret konkludim nëse i akuzuari e ka privuar ose jo nga jeta Arif Rexhepin.

Gjykata gjithashtu hodhi poshtë propozimin e prokurorit publik për t'i dërguar për analizë të ADN-së provat materiale E1 (një dorëze të majtë të gjetur jo larg nga vetura), E7 (mbulesën e ulëses së përparme të shoferit dhe mbulesën e mbajtëses së kokës) dhe

E9 (një batanije të gjetur në ulësen e pasme të pasagjerit), sepse nga rezultati i analizës së ADN-së nuk kanë mundur të sigurohen informacione të reja shtesë. Po të ishin gjetur gjurmë të ADN-së që përputhen me ADN-në e të akuzuarit, do të vërtetohej se i akuzuari kishte qenë në kontakt me ato gjëra e sidomos sa i përket gjurmëve në mbulesën e ulëses së parë të pasagjerit dhe mbulesën e mbajtëses së kokës, atëherë do të mund të nxirrej konkluzioni se i akuzuari ishte ulur në një kohë në ulësen e përparme të pasagjerit në veturën e Arif Rexhepi. Mirëpo, prapëseprapë qëndron mundësia që i akuzuari ishte ulur në veturë madje edhe para se të hynte në kafeteri së bashku me Arif Rexhepin, kur u largua nga kafeteria – dhe ndoshta edhe kur po kalonte pranë dyqanit të Fadil Rexhepit -, por që ishte larguar nga vetura para se Arif Rexhepi të arrinte në vendin e incidentit

Gjykata nuk sheh ndonjë provë të mëtutjeshme që do të shqyrtohej sipas detyrës zyrtare.

**Procesmbajtësja**  
**Noora Aarnio**



**Kryetarja e trupit gjykues**  
**Christine Lindemann-Proetel**

**Këshillë juridike:**

Personat e autorizuar mund të parashtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimin Gjykatën Supreme të Kosovës nëpërmjet Gjykatës së Qarkut në Mitrovicës brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data dorëzimit të kopjes së këtij aktgjykimi.